



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 937 Prot

Tiranë më 22.02..2018

VENDIM

Nr. 1, datë 22.02.2018

“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit strategjik të zhvillimit të Universitetit të Tiranës ”

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe bazuar në vendimin nr.24, datë 20.11.2017 të Senatit Akademik “Për miratimin e Planit të Veprimit me qëllim përmbushjen brenda afatit të përcaktuar të të gjitha rekomandimeve të Vendimit të Bordit të Akreditimit nr.62, datë 21.09.2017”, me qëllim realizimin e planit strategjik të zhvillimit të Universitetit të Tiranës , duke u mbështetur në propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik i UT-ës në mbledhjen e datës 22.02.2018:

VENDOSI

1. Ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit strategjik të zhvillimit të Universitetit të Tiranës me përbërje si më poshtë :
 - Gentina Kera koordinator
 - Artan Fuga anëtar
 - Shyqyri Llaci anëtar
 - Skerdian Kurti anëtar
 - Ariola Bacu anëtar
 - Çlirim Duro anëtar
 - Marsela Sako anëtar
 - Fatma Shijaku anëtar
 - Dejana Kallogjeroviç anëtar
2. “Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë dhe të njësive përbërëse të tij, si edhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.
3. Grupi i punës duhet të paraqesë në Rektorat Draft- Raportin brenda datës 15.04.2018, i cili do të paraqitet për miratim në Senatin Akademik.
4. Ngarkohet grupi i punës të pregatisë një kalendar për të zhvilluar takime të hapura me asamblatë e personelit akademik në njësitë kryesore brenda datës 15.03.2018.
5. Grupi i punës, do të paguhet për punën e kryer sipas legjislacionit në fuqi.
6. Ky vendim i dërgohet për zbatim Zv Rektorit për anën mësimore, Administratorit të UT, Njësive Kryesore, Filialit në Sarandë, Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporteve Universitare, Drejtorive ndihmës akademike me karakter administrativ dhe Drejtorive administrative të Rektoratit dhe Këshillit Studentor të UT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI